



01 Nr. 159/25 Dt. 04.03.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, Marrëveshjes së Sponsorizimit të nënshkruar ndërmjet Shoqatës “Aces Europe” me qendër në Bruksel (Belgjikë) dhe Komunës së Prizrenit, datë 17.12.2024, vendimit 01 nr. 014/25 datë 14.01.2025 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Lejohen mjetet financiare për pagesë të shpenzimeve të udhëtimit (biletave dhe shpenzimeve tjera të udhëtimit), ushqimit dhe akomodimit, për anëtarët e Komitetit të Vlerësimit të ACES Europe, të cilët do ta vizitojnë zyrtarisht Komunën e Prizrenit nga data 15 qershor 2025 deri me 18 qershor 2025, kështu që, në emër të pagesës së shpenzimeve përkatëse të udhëtimit dhe faturave për ushqim dhe akomodim, dhe shpenzimeve tjera eventuale, lejohen mjetet e nevojshme financiare.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.